



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 284, datë 17.12. 2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“PËR MËNYRËN E KOMPENSIMIT PËR ORËT SHITESË TË PUNËS TË KRYERA  
NGA NËPUNËSIT CIVILË TË PROKURORISË”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 189, pika 1, germa “c”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 84, pika 4, të Ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në Pikën 5, Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 732, dt. 13.11.2019, “Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të kryera nga nëpunësit civilë të prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

